

SHIFRA E NXËNËSIT

## PROVIMI I MATURËS

JANAR 2017

# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

### U D H Ë Z I M

KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 180 MINUTA

Gjatë testit nuk lejohet përdorimi i pajisjeve elektronike.  
Nxënësi/nxënësja nuk guxon në asnjë mënyrë ta zbulojë identitetin e vet në test ose t'i drejtohet vlerësuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.  
Testi **DUHET** të zhvillohet me laps kimik i cili nuk mund të fshihet.

Testi përmban detyra në të cilat do të përgjigjeni në njërën prej këtyre mënyrave:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë
- duke shkruar një përgjigje të shkurtër
- duke shkruar një përgjigje më të gjatë
- duke shkruar ese

Me testin ke marrë edhe **fletën e përgjigjeve** për detyrat me zgjedhje të shumëfishtë.

Nevojitet që në vendin përkatës me kujdes t'i përshkruash përgjigjet tua.

**Detyra do të vlerësohet me (0) pikë nëse:**

- është e pasaktë
- janë rrethuar më shumë përgjigje të ofruara
- është e palexueshme dhe e paqartë
- zgjidhja është shkruar me laps të thjeshtë

Nëse gabon vendos një vijë të kryqëzuar mbi të dhe detyrën zgjidhe përsëri. Kur ta përfundosh zgjidhjen e testit, kontrolloji edhe njëherë përgjigjet tuaja. Me fat!



\* A 7 3 8 2 5 \*




# FAQE E ZBRAZËT

## Duke shfrytëzuar tekstin *TRANSPORTI URBAN DERI TE AEROPORTI I PODGORICËS* përgjigju në pyetjet 1, 2, 3, 4 dhe 5.

### TRANSPORTI URBAN DERI TE AEROPORTI I PODGORICËS

Stacioni i autobusit në aeroport ndodhet para terminalit të ndërtesës. "Çmimi i biletës në një drejtim është dy euro, dhe blihet në autobus", është kumtuar nga NP Aerodromet e Malit të Zi.

Autobusët janë të ulët dhe me rampa të përshtatshme për karrocet e fëmijëve dhe personat në karrocet e invalidëve.



(përgatitur sipas burimit *CdM*, botuar më 11 nëntor 2015)

**1. Çfarë është paraqitur në figurë?**

1. plani i qytetit
2. traseja e rrugës dhe orari i udhëtimeve
3. harta e trafikut të Malit të Zi

*Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë*

**2. Në sa ora niset autobusi i parë drejt Aeroportit Podgorica nga stacioni pranë Tempullit?**

---

*1 pikë*

**3. Çfarë është shënuar me numrin tre në hartë?**

1. Stacioni Sheshi i Republikës
2. Stacioni Ura e Vjetër në Ribnicë
3. Stacioni Bulevardi Stanko Dragojeviq

*Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë*

**4. Nëse stacioni i nisjes është Aeroporti Podgorica, ku duhet prituri autobusin urban?**

---

*1 pikë*

**5. Cila është përparësia e autobusëve urban të cilët vozisin deri në aeroport?**

---

*1 pikë*

## **SHKENCËTARËT E NJOHUR**

Shkenca është një sistem njohurish për realitetin objektiv të cilën, me përdorimin e metodave përkatëse shkencore, e kanë sistematizua dhe argumentuar rreth 1500 njerëz të shquar nga e gjithë bota që me zbulimet dhe shpikjet e tyre dhanë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e shkencës. Edhe sot janë të njohur anë e kënd botës shkencëtarët sikurse Amperi, Boreli, Bori, Laplasi (Franca), Bajes, Njutni, Hopkinsi, Woodsoni (Anglia), Ajnshtajni, Kepleri, Omi, Lajbnici (Gjermania) dhe të tjerët. Më tepër se 100 shkencëtarë kanë dhënë SHBAT-të, Italia rreth 100, Rusia rreth 80 emra të tillë.. Vend të rëndësishëm në shkencë zënë Polonia, Ukraina, Turqia, Greqia, Holanda, Hungaria dhe Austria të cilat i dhuruan shkencës rreth 30-50 shkencëtarë. Disa vende të tjera, edhe pse kanë numër më të vogël shkencëtarësh të njohur, dhanë një kontribut të madh të tilla janë: Irlanda me 20 shkencëtarë, Suedia me 12 sa ka dhënë edhe Spanja, pastaj vinë Norvegjia dhe Kina me nga 10 shkencëtarë, Kanada me 8 ...

Për disa shkencëtarë të rëndësishëm mësojmë vetëm nëpërmjet teksteve shkollore, ku jepen ligjet, teoremat, eksperimentet, pajisjet që ata kanë shpikur...Portrete e disa prej tyre mund t'i shohim në pullat postare sepse disa vende lëshojnë pulla postare me rastin e shënimeve të përvjetorëve të personaliteteve të shquara dhe të arriturave të tyre . Prandaj filatelistët kanë në dispozicion shumë tema të cilat lidhen me shkencëtarë dhe veprimtar të tjerë nga sferat e ndryshme të jetës, të cilët me punën dhe aktivitetet e veta kanë i kontribuar zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Në pulla janë për shembull, Robert Koh ose Albert Ajnshtajn, veprat e të cilëve në fushën e gjetjes së barit mjekues kundër tuberkulozit, përkatësisht zbulimit të teorisë së relativitetit kanë lënë gjurmë të thellë në shoqërinë bashkëkohore.

### **Rëndësia e vitaminave**

Shumicën e vitaminave i sintetizojnë bimët ashtu që ushqimi me prejardhje bimore është i domosdoshëm për zhvillimin normal dhe funksionimin e organizmit. Rolin vendimtar në zbulimin e vitaminave kanë pasur çrregullimet e sëmundjeve të cilat lindin si pasojë e mungesës së tyre në ushqim. Për sëmundjen e detarëve, skorbutit (sëmundje që shfaqet me dobësi trupore të përgjithshme dhe me rrjedhje gjaku sidomos nga mishi i dhëmbëve, si pasojë e mungesës së vitaminave në ushqim), është ditur se është shkaktuar nga ushqimi i gjatë në të cilin mungonte gjella prej bimëve (më vonë është zbuluar se është në pyetje mungesa e vitaminës C). Kirurgu skocez Xhejms Lind në vitin 1749 ka zbuluar se limoni ndihmon në parandalimin e sëmundjes së skorbutit dhe e ka rekomanduar në Traktatin e vet për skorbutin si pemë që pengon paraqitjen e kësaj sëmundjeje. Viti 1912 ishte vendimtar për zbulimin e vitaminave. Këtë vit së pari shkencëtari Hopkins e ka dëshmuar që për rritjen normale dhe zhvillimin e shtazëve nevojitet prania e disa përbërësve shtesë, përveç materieve organike themelore (lipideve, sheqerit, proteinave). Të njëjtin vit për të parën herë e ka përdorur termin vitaminë Kazimir Frank, kur edhe e ka izoluar vitaminën e parë nga lëvozhgët e orizit. Sipas përbërjes kimike ky ishte amini i cili pengonte paraqitjen e sëmundjes beri-beri, përndryshe shumë sëmundje e përhapur ndër popullatë të Azisë ushqimi i të cilëve bazohet në orizin e qëruar. Franku këtë amin e quajti vitaminë (latinisht

vita-jeta). Termi ka mbetur në përdorim deri më sot edhe pse dihet se numri më i madh i vitaminave nuk i takon grupit të amineve.

*Përgatitur sipas teksteve nga gazetat "Shekulli", 22.1.2008, "Politika", 13.9.2008 dhe sajt i www.bionet-skola.com)*

**6. Sa shkencëtarë kanë dhënë kontributin e vet për zhvillimin e shkencës në botë?**

---

1 pikë

**7. Rrethoje numrin para emrit të vendit që ka dhënë më tepër se 100 shkencëtarë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.**

1. SHBA
2. Italia
3. Rusia

1 pikë

**8. Përse Robert Koh e ka merituar të gjendet në pullën postare?**

---

---

1 pikë

**9. A) Rrethoje numrin para shkencëtarit anglez që ka merita për zbulimin e vitaminës dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.**

1. Hopkinsi
2. Lindi
3. Njutni
4. Woodsoni

1 pikë

## B) Shpjegoje përgjigjen.

---

---

---

1 pikë

- 10.** Fjala vitaminë, siç e ka quajtur shkencëtari Frank aminin e izoluar nga gëzhutat e orizit, është krijuar nga fjala latine *vita*, që do të thotë jetë. Çka dëshirohet të theksohet me këtë term që është edhe sot në përdorim?

---

---

1 pikë

### Lexoje fragmentin pastaj përgjigju në pyetjet 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Me gjithë përpjekjet e tyre dhe nënshtrimin e K. pozicioni i zgjedhur nuk ishte as i mirë as i përshtatshëm. Pastaj njëri prej tyre zbërtheu xhakëtën dhe nxori një hanxhar kasapi nga këllëfi, që i varej përgjatë jelekut. E ngriti lart thikën e madhe. Tehu vezulloi në dritën e hënës. Nisi pastaj një ceremoni e neveritshme, sepse njëri ia zgjati thikën tjetri sipas kokës së K. Ndërsa ky ia ktheu prapë, duke e kaluar përsëri sipër kokës së K. Atë çast K. tha me vete se mbase i duhej atij vetë të merrte thikën dhe ta rrate në kraharor. Nuk e bëri, vetëm rrotulloi qafën e lirë dhe këqyri përreth. Nuk mund t'ua lehtësonte mendimin autoriteteve, i mungonte për këtë energjia e nevojshme që këta ia kishin shteruar. **Vështrimi i K. u ndal te kati i sipërm i shtëpisë, që ndodhej pranë gurores. Papritur u hapën kapakët e një dritareje dhe shpërtheu drita. U duk një burrë i hollë i gjatë, që u përkul përpara në parvaz dhe nderi duart përpara. Kush ishte? Ndonjë mik? Ndonjë njëri i mirë? Ndonjë që donte ta mbronte? Një ishte apo ishin disa? A thua kishte ende mundësi që të shpëtonte?** Mos vallë, mund të bëhej gjë? Apo kishte ende fakte, që nuk ishin paraqitur? Me siguri që kishin. Ngjante sikur nuk kishe si luftoje me atë lloj logjike, por ama dëshira për të jetuar ishte shumë e madhe. Ku ndodhet, vallë, ai gjykatësi më i epërm, të cilin s'e kishte parë kurrë? Ku ishte Gjykata e Lartë, te e cila nuk kishte mundur të arrinte? Ngriti lart duart dhe i hapi shumë gishtat.

Njëri prej dy zotërinjve e zuri K. prej gryke, kurse tjetri ia nguli thikën thellë në zemër dhe e rrotulloi dy herë. Me sytë ku po shuhej drita i pa zotërinjtë, që ishin përkulur mbi të ashtu pranë për të parë fundin e punës së bërë.

- Si ndonjë qen! Belbëzoi K. dhe iu duk sikur trupi do të mbijetonte edhe pas tij.



**11.** A) Shkruaje titullin e veprës nga e cila është marrë ky fragment.

---

1 pikë

B) Kush është autori i veprës?

---

1 pikë

**12.** Ku qëndron absurdi në këtë vepër?

---

---

---

1 pikë

**13.** Autori në qendër të gjithë ngjarjes shtjellon:

1. konfliktin e individit dhe shoqërisë së kohës
2. konfliktin në mes të dy personazheve
3. mosmarrëveshjet familjare të kohës

*Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve* 1 pikë

**14.** Pjesa e errësuar nga teksti i mësipërm ka një domethënie. Sqaroje atë.

---

---

1 pikë

**15. Në fjalinë *Si ndonjë qen!* autori përdor figurën stilistike të:**

1. alegorisë
2. ironisë
3. krahasimit

*Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve* 1 pikë

**16. Nga fjalia e dhënë përshkruaje fjalinë e nënrenditur kohore.**

Ndërsa po i mbante sytë mbyllur, ajo dëgjoji një zë të vrazhdë, që po fliste plot ëmbëlsi.

---

1 pikë

**17. Në cilën mënyrë është folja e nënvizuar në fjalinë: *Edhe shtatit trim i paska dhanun*?**

1. lidhore
2. dëftore
3. habitore
4. dëshirore

*Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve* 1 pikë

**18. A) Përshkruaje kohën e tashme të foljes nga vargjet:**

Mblidhen shokët mbrëmanet  
në katund në vatëret,  
Unë i lash si ëndërrëz.

---

1 pikë

**B) Koha e tashme e kësaj foljeje në kontekstin e përdorur shpreh një:**

1. veprim në vazhdimësi
2. veprim të përfunduar
3. veprim të papërfunduar

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

**19.** Qyteti im nuk ka parkingje të mjaftueshme.

**Cili ndryshim tingullor është zhvilluar në fjalën e nënvizuar?**

\_\_\_\_\_

1 pikë

**20.** A) Qielli është më i qetë, më i heshtur e nëpër të lundrojnë re të praruara.

**Nga fjalia përshkruaji mbiemrat e shkallës krahasore.**

\_\_\_\_\_

1 pikë

**B) Mbiemrat e shkallës krahasore shkruaji në shkallën sipërore.**

\_\_\_\_\_

1 pikë

**21.** A) Amaranta nuk doli nga dhoma e gjumit.

**Në cilën rasë janë emrat e nënvizuar?**

Amaranta - \_\_\_\_\_

dhoma - \_\_\_\_\_

gjumit - \_\_\_\_\_

1 pikë

**B) Shumica e shkrimtarëve tanë shkruan për atdheun tonë.**

**Në cilën rasë janë përemrat e nënvizuar?**

**22. Nënvizoji tri konstatime që kanë të bëjnë me letërsinë gojore.**

1. sinkretizmi
2. krijimi individual
3. epiteti i ngulitur
4. gjinia dramatike e diferencuar
5. fillimi dhe përfundimi stereotip

1 pikë

**Lexoji disa nga vargjet e poemës “Andrra e jetës”, përkatësisht të vjershës “Lokja” e Ndre Mjedës pastaj zhvilloji detyrat 23, 24, 25, 26 dhe 27.**

**LOKJA**

E n'balkue mbaruene lulet:  
Shurdha a vendi e shpia tytë,  
Jo, me Lokën një e dytë  
Nëpër shpi ma nuk e gjet.

Vetun zbardh e vetun erret  
Me kry n'hi e shuemja plakë;  
Nji dorë krande me i ba flakë  
Përmbi vatër kush s'ia qet.

E disprueme me vetvedi  
Që nuk bani kurrë një djalë:  
Sot e reja i kish dalë  
Bashkë me dritë për dru në shpat

...

**23. Në vargjet e veçuara, ashtu si edhe në tërë këngën në përgjithësi, Mjeda flet për:**

1. vetminë dhe ftohtësinë që shkakton dimri
2. vetminë e paqetësueshme të një femre
3. vazhdimësinë e pandalshme të jetës

*Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve* 1 pikë

**24.** Si quhet vargu me të cilin janë shkruar këto vargje?

\_\_\_\_\_

1 pikë

**25.** Çfarë simbolizon Lokja në këtë këngë?

\_\_\_\_\_

1 pikë

**26.** Shkruaje domethënien e fjalëve të veçuara nga fragmenti:

Shurdh a vendi - \_\_\_\_\_

tytë - \_\_\_\_\_

e reja - \_\_\_\_\_

2 pikë

**27.** Me kry n' hi e shuemja plakë;

**Cili do të ishte sinonimi i fjalës së nënvizuar dhe çfarë ngarkese emocionale mbart ajo?**

e shuemja - \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

2 pikë

**28.** Në bazë të fragmentit shkruaje titullin e veprës letrare dhe emrin dhe mbiemrin e autorit të saj.

1. Mora një telegram nga azili: “Nëna vdiq. Varrimi nesër. Ngushëllime të singerta”. Kjo s’do të thotë asgjë. Ndoshta ka ndodhur dje.  
Azili i pleqve ndodhet në Marengo, tetëdhjetë kilometra larg Algjerit.
- 

2. Ai pranë dritares  
nuk jam unë  
është jot ëmë  
që të kërkon në turmë
- 

3. Nëpër shesh’ e nër bregore, janë përhapur shqerrat,  
E kecërit nëpër rripa, dhe në gjethet e në ferrat;  
Sa me vrap e me gas bredhin, edhe lozin shoku me shok,  
Aty përhapenë me nxit, aty mblidhenë prapë tok,
- 

*3 pikë*

**29.** Shkruaje personazhin i cili i thotë këto vargje në veprën “Juda Makabe”.

1. A krejt, thue, t’hiku ushtria?
- 

2. Po krejt. Nja pesëqind vetë  
Ma tepër nuk m’kanë mbete.
-

3. Njimend, si thue, Zotni,  
A e shkrefim luftën sot?  
Po mbledhimdo ushtri tjera,  
E, mbas t'jem' forcue,  
M'anmik prap kem' me u lshue  
Me ndihmë të madhit Zot.

3 pikë

**30.**

Janë ofruar dy tema për hartimin e esesë. Rretho numrin para temës që do ta zhvillosh. Eseja duhet të përmbajë 250 deri në 300 fjalë.

Hartoje atë si tërësi që duhet të ketë hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin. Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHE T FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi).

Gjatë hartimit të esesë kij kujdes për mënyrën e të shprehurit dhe për zbatimin e normave drejtshkrimore. Shkruaj lexueshëm.

## 1. Ky planet është i shenjtë

Lexoji me kujdes fragmentet nga *Letra e prijësit të indianëve të Sietllit* si dhe udhëzimet për shkrimin e esesë.

### Letra e prijësit të indianëve të Sietllit

Teksti në vazhdim është letra e një prijësi të indianëve të Sietllit, shkruar në vitin 1854 dhe dërguar kryetarit të atëhershëm të SHBA-së, Frenklin Pirs-it në Uashington. Shkas për letrën ishte dëshira e kryetarit të SHBA-së për të blerë nga indianët një copë të madhe të tokave të tyre.

Si mund ta blejë apo ta shesë dikush qiellin, ngrohtësinë e tokës? Këto mendime për ne janë të huaja. Nëse freskia e ajrit dhe kthjelltësia e ujit nuk janë prona jonë, si mund t'i blini ju ato? Çdo pëllëmbë e kësaj toke është e shenjtë për popullin tim. Çdo halh që shkëlqen i pishës, çdo breg zallor, çdo mjegullnajë në errësirën e pyllit, çdo insekt që zukat, janë të shenjtë në mendimet dhe jetën e popullit tim. Lëngjet që rrjedhin në drunj bartin kujtime për popullin tim dhe përvojën e tij.

Prandaj, kur Prijësi i Madh i Bardhë nga Uashingtoni çon fjalë se dëshiron ta blejë tokën tonë, kërkon tepër shumë prej nesh. Ne do ta shqyrtojmë ofertën tuaj për ta blerë tokën tonë. Por kjo nuk do të jetë diçka e lehtë. Sepse për ne, kjo tokë është e shenjtë. Ky ujë shkëlqyes, që rrjedh në përrrenjtë e rrëmbyeshëm dhe lumenj, nuk është vetëm ujë, por edhe gjaku i të parëve tanë. Nëse jua shesim tokën, duhet ta mbani mend se ajo është e shenjtë dhe duhet t'i mësoni fëmijët tuaj se ajo është e shenjtë dhe se çdo refleksion i dritës në ujin e kthjellët tregon diçka për ngjarjet nga jeta e popullit tim. Gurgullima e ujit është zëri i babait të babait tim.(...) Ne e dimë se njeriu i bardhë nuk e kupton mënyrën tonë të jetës. Njëra pjesë e tokës për të është njësoj si një pjesë tjetër, sepse ai është një i huaj që vjen natën dhe merr nga toka gjithçka që do. Toka për të nuk është vëlla, por armik dhe kur e nënshtron, ai shkon më tutje. Pas vetes lë varret e etërve të vet dhe për këtë nuk e çan kokën. Ua rrëmben tokën fëmijëve të vet dhe nuk brengoset. I harron varret e etërve të vet dhe të drejtat që fëmijët e tij i kanë fituar me lindje. Ndaj nënës tokë dhe ndaj vëllait të vet silltet si ndaj gjësendeve që mund të blihen, të plaçkiten, të shiten, si bagëtia apo si stolitë që shkëlqejnë. Lakmia e tij do ta shkatërrojë tokën dhe pas vetes ka për të lënë shkreti. (...)

Nëse vendosim që t'ua shesim tokën, do t'ua vëmë një kusht: Njeriu i bardhë duhet të silltet ndaj kafshëve të kësaj toke si ndaj vëllezërve të vet. Kam parë mijëra bizonë duke u kalbur në preri, sepse i ka lënë njeriu i bardhë duke i vrrarë nga treni në parakalim. Unë jam i egër dhe nuk e kuptoj se si kali i hekurt që qet tym mund të jetë më i rëndësishëm se bizoni, të cilin ne e vrasim vetëm për të mbetur gjallë. Ç' është njeriu pa kafshët? Nëse të gjitha kafshët shkojnë, njeriu do të vdesë nga vetmia e madhe e shpirtit. Çfarëdo që t'u ndodhë kafshëve, së shpejti do t'i ndodhë edhe njeriut.

U thoni fëmijëve se tokën e kemi farefis. Mësoni fëmijët tuaj, siç bëjmë edhe ne me fëmijët tanë, se toka është nëna jonë. Çfarëdo që të ndodhë me tokën – do të ndodhë edhe me bijtë e tokës. Nëse njeriu pështyn në tokë, pështyn në vetveten. Toka nuk i përket njeriut; njeriu i përket tokës.

Njeriu i bardhë do të zhduket, ndoshta edhe para fiseve të tjera. Por, gjatë zhdukjes suaj do të shkëlqeni në mënyrë verbuese me zjarrin e Zotit, i cili u ka sjell këtu dhe me një qëllim të pashpjegueshëm jua ka dhënë pushtetin mbi këtë tokë dhe njeriun e kuq. Ky fat për ne është një mister, nuk e dimë përse vritet bizoni, përse zbuten kuajt e egër, përse në thellësitë e pyllit ka kaq shumë gjurmë njerëzore, përse shikimi në kodrat e gjelbra është ndotur me tela që flasin. Ku është pylli i dendur? Është zhdukur. Ku është shqiponja? Ka ikur. Jeta ka marrë fund. Fillon lufta për mbijetesë.

*Marrë nga: Stilet e shëndetshme të jetës, Enti për Tekste dhe Mjete Mësimore, Podgoricë 2009.*



## Udhëzime për shkrimin e esesë:

→ Thekso:

- si është sot gjendja e mjedisit jetësor në botë,
- kur është shkruar letra dhe me të cilin qëllim.

→ Paraqite mendimin e prijësit të indianëve për blerjen dhe shitjen e tokës.

→ Trego se si njeriu i kuq e përjeton tokën, kafshët dhe çfarë raporti ka ndaj tyre.

→ Trego për apelin dramatik të prijësit të indianëve.

→ Komentoje motivin i cili, sipas mendimit të prijësit, e nxit njeriun e bardhë në një qëndrim të papërgjegjshëm ndaj natyrës.

→ Trego për shembujt e sjelljeve të panjerëzishme të njeriut të bardhë ndaj tokës, kafshëve.

→ Paraqite:

- përjetimin tënd të letrës së prijësit indian,
- gjykimin tënd për qëndrimet e prijësit indian dhe shpjegoje atë.

## 2. “Porta e Ferrit” nga vepra “Komedia Hyjnore”

**Lexoji me kujdes vargjet nga “Porta e Ferrit” (nga Ferri Kënga III) si dhe udhëzimet për shkrimin e esesë.**

KËNDEJ KALOHET NË QYTET T’MJERIMIT,  
KËNDEJ KALOHET N’DHIMBJEN PA KUFÏ,  
KËNDEJ KALOHET N’SHPIRTNAT HUMBUN SHQIMIT.

KRIJUESIN TIM E SHTY DREJTËSIA E TIJ;  
VETË PUSHTETI HYJNOR MË KA SAJUE,  
MA E LARTA DIJE, E PARA DASHUNI.

PARA MEJE GJA TJETËR S’U KRIJUE,  
VEÇSE E PËRJETSHME–E UNË QËNDROJ PËRJETË:  
O JU QË HYNÏ MBRENDË KENÏ MBARUE!

Ja, këto fjalë, me shkronjë t’zeza, vetë  
i pashë të shkrueme mbi një portë, me drojë  
pëshprita: “Pris, a e sheh ç’më paska gjetë!”

Prisi m’u gjej, si ai që ka përvojë:  
“Ktu çdo dyshim mbas shpine duhet lanë,  
çdo frikë e përpëlajtje të mbarojë!

Na kemi arrijtë n’atë vend ku t’pata thanë,  
ku do shikosh ti shpirtnat e brengosun,  
që fillin e arsyes humbun e kanë.”

Pastaj mbi timen dorën tue e vendosun,  
gëzueshëm në ftyrë, që shpirtin lart t’ma mbajë,

më futi mbrenda jetës së pasosun.

**Udhëzime për shkrimin e esesë:**

→ Shkruaj për:

- Strukturën e “Komedisë Hyjnore”,
- Subjektin e veprës “Komedia Hyjnore”,
- Personazhet e Komedisë Hyjnore dhe rëndësinë e tyre në vepër (Beatriçija dhe Virgjili),
- Vizionin e poetit për “përtejbotën” dhe udhëtimin e tij nga tmerri te e mrekullueshmja,
- Domethënien e fjalëve të gravuara mbi Portën e Ferrit,
- Gjendjen emocionale të poetit, kur ndodhet para hyrjes në vendin e të të humburve,
- Mbështetjen dhe dorën që i ofron Virgjili për fillimin e udhëtimit në “përtejbotë”.

*25 pikë*











1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				
15.				

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9

1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				

1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				
15.				

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9